

## **Hapet thirrja për aplikime për personelin me kohë të plotë të Universitetit të Tiranës në Universitetin Cankiri Karatekin, Turqi, për semestrin e dytë të vitit akademik 2022-2023.**

Në kuadër të programit Erasmus+ është hapur thirrja për aplikime për bursa për mësimdhënie dhe trajnim për personelin me kohë të plotë të Universitetit të Tiranës në Universitetin Cankiri Karatekin, Turqi, për semestrin e dytë të vitit akademik 2022-2023.

<https://erasmus.karatekin.edu.tr/>

<https://aday.karatekin.edu.tr/en/>

### **Llojet e mobilitetit përfshijnë:**

-Shkëmbimin për personelin me kohë të plotë për mësimdhënie / trajnim.

### **Kohëzgjatja:**

- 5 ditë;

### **Bursat përfshijnë:**

-Kompensim ditor (140 EUR për stafin);

-Kostot e udhëtimit (në varësi të distancës midis universitetit pritës dhe atij të origjinës)

<b>DISTANCA E UDHËTIMIT</b> ( <a href="http://ec.europa.eu/programmes/erasmus-plus/tools/distance_en.htm">http://ec.europa.eu/programmes/erasmus-plus/tools/distance_en.htm</a> )	<b>Kompensimi</b>
<b>Midis 100 dhe 499 KM</b>	180 EUR
<b>Midis 500 dhe 1999 KM</b>	275 EUR
<b>Midis 2000 dhe 2999 KM</b>	360 EUR
<b>Midis 3000 dhe 3999 KM</b>	530 EUR
<b>Midis 4000 dhe 7999 KM</b>	820 EUR
<b>8000 KM ose më shumë</b>	1100 EUR

Për të përcaktuar distancën ju lutemi referohuni:

[http://ec.europa.eu/programmes/erasmus-plus/tools/distance\\_en.htm/](http://ec.europa.eu/programmes/erasmus-plus/tools/distance_en.htm/)

### **Dokumentet e nevojshme për aplikim për personelin me kohë të plotë:**

- CV (në gjuhën angleze / turke);

- Formulari i Aplikimit:

<https://krtknadmn.karatekin.edu.tr/files/erasmus/ERASMUS%20APPLICATION%20FOR%20STAFF.doc>

- Kopje e Pasaportës;

- Letër motivimi (në gjuhën angleze / turke);

- Vërtetim Punësimi (në gjuhën shqipe);

- Certifikata e gjuhës së huaj angleze / turke;

- Vetëdeklarim nëse keni kryer apo jo më parë një mobilitete Erasmus+ (nëse po, ku);

- Plani i mobilitetit për trajnim dhe mësimdhënie;

Për të shkarkuar formatin e Planit të Mobilitetit për Mësimdhënie klikoni në adresën:

<https://krtnadmn.karatekin.edu.tr/files/erasmus/KA107%20Staff%20Mobility%20Agreement%20for%20Teaching.docx>

Për të shkarkuar formatin e Planit të Mobilitetit për Trajnim klikoni në adresën:

<https://krtnadmn.karatekin.edu.tr/files/erasmus/KA107%20Staff%20Mobility%20Agreement%20for%20Training.docx>

Plani i Mobilitetit është një dokument në të cilin duhet të specifikohet programi juaj i propozuar që do të kryeni gjatë periudhës së mësimdhënies / trajnimit. Ky dokument firmoset nga aplikanti në momentin e aplikimit dhe më pas nga Koordinatori Institucional Erasmus+.

Afati për aplikim: **25 Tetor 2022**

Dokumentat duhen dorëzuar dorazi në Rektoratin e Universitetit të Tiranës, Sektori i Marrëdhënieve me Jashtë, si dhe duhet të dërgohen të skanuara në e-mailin [iro@unitir.edu.al](mailto:iro@unitir.edu.al).

Për më shumë informacion mbi bursat mund të na kontaktoni në adresën: [iro@unitir.edu.al](mailto:iro@unitir.edu.al).

Universiteti i Tiranës ju uron suksese në aplikimin tuaj!